RELACIONI TEKNIK

OBJEKTI: "REHABILITIM I SKËMËS UJITËSE DOBRUNË" - BASHKIA HAS

PËRGATITI:

"LC-LINK" SH.P.K.

ADIMINISTRATORI

ING. EDMOND XHUVELI

OBJEKTI: "REHABILITIM I SKËMËS UJITËSE DOBRUNË", BASHKIA HAS

I.- HYRJA

Zona ku do të trajtohet rehabilitimi i skemës ujitjëse Dobrunë, nga pikëpamja gjeografike përfshin krahun e djathtë të luginës së përroit të Rosmanit, duke filluar nga vepra e marrjes së vendosur pranë ujëlëshuesit të rezervuarit (ujëlëshuesi i rezervuarit të Dobrunës) që ndodhet në perëndim të fshatit Dobrunë vazhdon përgjatë shpateve të m. Kalazarit dhe m. Malit. (Shih planimetrinë e zonës në Sh. 1 : 25 000). Skema ujitëse përbëhet nga kanali kryesor KU-1 dhe rrjeti i kanaleve shpërndarëse KU1-1, KU1-2, KU1-3 dhe KU1-4, të cilët sigurojnë shpërndarjen e ujit drejt sipërfaqeve bujqësore të zonës së projektit.

Kryesisht tokat e ujitshme të këtij sistemi, shtrihen, në një zonë malore me lartësi që lëviz nga 650 deri ne 500 m m.n.d.. Masivi i tokave që do të ujiten nga ky kanal dhe degëzimet e tij, megjithëse me parcelizme të vogla, përgjithësisht është i sistemuar dhe tepër i kultivuar.

Ndër kulturat bujqësore që mbillen, një vënd tepër të rëndësishem zënë drithrat dhe foragjerët pastaj kulturat e tjera bujqësore.

II.- TE DHENA TE DETYRES SE PROJEKTIMIT

Detyra e projektimit është hartuar nga Qëndra e Transferimit të Teknologjive Fushë-Krujë në bashkëpunim me Bordin e Kullimit Kukës. Kjo detyrë kërkon që të hartohet projekti zbatimit për objektin: **"Rehabilitim i Skemës Ujitëse Dobrunë", Bashkia Has** për të ujitur tokat e fshatrave Golaj dhe Nikoliq duke patur parasysh sa më poshtë:

1.- Siperfaqja që kërkohet të ujitet është 400 ha.
2.- Kulturat që mbillen në këto sipërfaqe janë të ndryshme.
3.- Rehabilitimin e plotë të kanaleve shpërndarëse KU1-1, KU1-2, KU1-3 dhe KU1-4, të cilat sigurojnë shpërndarjen e ujit në sektorët përkatës të sipërfaqeve bujqësore.
5.- Të shihet gjëndja e kalimeve me tub çeliku nëse duhen riparuar apo zëvendesuar.
6.- Të parashikohet riparim vepra arti egzistuese ose të ndërtohen vepra arti të reja.
7.- Parashikohet riparimi ose rindërtimin lokal i veshjes së betonit në segmentet ku konstatohet degradim, çarje ose dëmtime strukturore, duke përdorur beton të klasës C16/20 me trashësi 8 cm, sipas kërkesave të projektit.
8.- Riprofilizimin dhe sistemimin e seksioneve të dëmtuara të kanaleve, duke ruajtur dimensionet dhe pjerrësitë e projektimit për garantimin e rrjedhjes së lirë të ujit.
9.- Përgatitjen e preventivit të punimeve, volumeve përkatëse dhe specifikimeve teknike, në përputhje me standardet dhe normativat teknike në fuqi, duke u bazuar në analizat e çmimeve përkatëse

III.- TOPOGRAFIA, GJEOLOGJIA DHE HIDROLOGJIA

Sipërfaqja që kërkohet të ujitet në përgjithesi është zonë kodrinore me pjerrësi të vogla, tokë e zakonëshme për kultivimin e të gjitha kulturave bujqësore. Lartësia mbi nivelin e detit e kësaj sipërfaqe toke është rreth 650 - 500 m m.n.d.. Tokat e fshatrave Golaj dhe Nikoliq që do plotësohen nga linja kryesore përgjithësisht janë toka të sistemuara mirë, gjë që krijon kushte të mira për ujitje, ndërsa KU 1-1, KU 1-2, KU 1-3 dhe KU 1-4 do jenë shpërndarsit e ujit në degëzime në fshatin Dobrune, dhe fshatrat e vegjël përgjatë linjës kryesore. Tokat që kërkohen të ujiten në përgjithësi janë të përbëra nga dhera suargjila dhe copra e blloqe magmatiku te shkateruar me ngjyre kafe, kafe te verdhe e vende vende kafe te kuqeremte, me përmbajtje deri 31% fraksione çakëllore dhe guralecë me përmbajtje kryesisht ranore, në gjendje mesatarisht të ngjeshur. Zona ku bën pjesë siperfaqja e tokës që do të ujitet bën pjesë në zonën klimatike kontinentale mesdhetare malore, me dimër të ftohtë e të lagesht dhe verë të nxehte e të thatë.

III.I- POZICIONIMI GJEOGRAFIK I OBJEKTIT

